



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Pemëtari - Vreshtari

**Programi:** Pemëtari Vreshtari

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Gëzim Murseli, me titull:  
**“Hulumtimi i vetive agro-biologjike te katër kultivarëve të mjedrës në kushte agro-ekologjike të Kosovës”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 25.04.2024 deri me datë 02.05.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. asoc. Mentor Thaqi anëtarë, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI**

**PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI**

**Tema:**

**HULUMTIMI I VETIVE AGRO-BIOLOGJIKE TE KATËR KULTIVARËVE TË  
MJEDRËS NË KUSHTE AGRO-EKOLOGJIKE TË KOSOVËS**

**Mentor:**

**Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu**

**Kandidati:**

**Bsc. Gëzim Murseli**

Prishtinë, 2024

## ABSTRAKTI

Në fermën “Hera Fruits” gjatë vitit 2018 është ngritur parcela eksperimentale për hulumtimin e vetive agrobiologjike të 4 kultivarëve të mjedrës Polka, Mapema, Sugana dhe Himbotop. Për secilin kultivarë janë mbjellë nga 30 bimë që janë përcjell përmes 3 përsëritjeve nga 1 m gjatësi e rendit, të vendosura në mënyrë të rastit sipas planit të rastësishëm në bllok të randomizuar. Në studim janë përfshirë hulumtimi i disa parametrave biomorfologjik: biologjik (gjatësia e vegetacionit, dinamika e lulëzimit) morfologjik (lartësia e lastarëve, lartësia e degëzave të para nga toka, gjatësia prodhuese e lastarit, parametrat e gjethit – gjatësia, gjerësia, Indeksi Sipërfaqësor Gjethor “ISGJ”), treguesit frutdhënës (numri i lastarëve për m gjatësi, numri i frutave për lastarë, prodhimi për lastarë dhe hektar), pomologjik (lartësia, gjerësia pesha dhe indeksi i frytit), dhe biokimik (Sheqeri Brix, materia e thatë, aciditeti, pH, Vitamina C dhe lagështia). Nga rezultatet e hulumtuara vërejmë një numër të ndryshimeve të parametrave biomorfologjik në mes të kultivarëve. Kultivari Mapema ka treguar lulëzim më të hershëm dhe vegetacion më të shkurtë ndërsa Himbotop lulëzim më të vonshëm dhe Sugana vegetacion më të gjatë. Himbotop dhe Sugana kanë krijuar numrin më të madh të lastarëve për metër gjatësi, ndërsa në gjatësinë e lastarëve dhe në shfaqjen e degëzave prodhuese përgjatë lastarëve pothuajse të gjithë kultivarët e hulumtuar kanë shfaqë tregues të ngjashëm. Sugana ka shfaqë përmasa më të mëdha të gjethit ndërsa Indeks të larët sipërfaqësor e ka shfaqur kultivari Himbotop. Numrin më të madh të frutave për lastarë e ka dhen kultivari Himbotop, ndërsa rendimentin më të madh për lastarë dhe për njësi të sipërfaqes e ka dhen kultivari Polka. Fruta më të mëdhenj kanë dhënë kultivarët Sugana dhe Mapema dhe më të vegjël kultivarët Himbotop dhe Polka. Kultivari Himbotop ka treguar vlera më të larta të sheqerit Brix , aciditetit, vitaminës C, dhe materies së thatë. Ndërsa kultivarët Sugana dhe Mapema kanë shfaqur vlera më të larta të lagështisë së frutave.

Fjalët kyçe: Mjedra, kultivarët, parametrat biomorfologjik.